

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA E NOTERISË TIRANË  
NR 2856 REP NR 718 KOL

Notere Dhimitra QARRI

Adresa : Blv Bajram Curri pranë Gjykatës së  
Rrethit Gjyqesor Tiranë Tel 251 200 / 0692095571



### KONTRATE SHITJE KUOTASH

Ne Tirane sot me daten 12.05.2006, para meje noteres publike Dhimitra Qarri e rregjistruar prane Dhomes se Noterise Tirane, me Zyre Noteriale ne Tirane ne Bulevardin Bajram Curri, u paraqiten personalisht shtetasit me cilesine e paleve pjesmarrese ne kontrate:

#### PALA SHITËSE

**Maksim Zhuzhi**, i biri i Ramadanit, datlindja 11.07.1979, lindur ne Diber dhe banues ne Tirane, per identitetin e te cilit u sigurova nga pasaporta nr. 1682870.

#### PALA BLERËSE

**Lirim Zhuzhi**, i biri i Ramadanit dhe i Festimes, datlindja 17.07.1974, lindur ne Diber, dhe banues ne Mezes, Tirane, mbajtes i certifikates me fotografi nr. 9/83, date 11.05.2006, leshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Kashar, Tirane, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar te cilet me vullnetin e tyre te lire dhe te plote me kerkuan mua noterit hartimin e kesaj kontrate shitblerje kuotash si me poshte :  
Pala shitesese eshte ortake e vetme e shoqerise „SAFE“ sh.p.k. rregjistruar si e tille me Vendim te Gjykates se Shkalles Se Pare Tirane nr. 30540, date 13.11.2003, me kapital themeltar te shoqerise eshte 4 000 000 (kater milion)leke. Ortaku i vetem i shoqerise me vendimin nr 1 date 11.05.2006, ka vendosur t'i shese z. Lirim Zhuzhi 100 % te kuotave te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise duke u larguar keshtu nga shoqeria. Cmimi i shitjes se 100 te kuotave eshte 4 000 000(katermilion) leke sa eshte vlere e kapitalit themeltar te shoqerise.

Pala blerese eshte plotesisht dakort qe ti bleje keto kuota me kushtet e vena sa me siper nga pala shitesese me gjendjen e aktivitetit dhe te pasivitetit te saj deri ne daten e lidhjes se kontrates .

Pala shitesese deklaroi se ka marre nga bleresi shumen 4 000 000 leke qe perfaqeson cminin e shitjes dhe nuk ka pretendime per kete pagese.

Me blerjen e ketyre kuotave z. **Lirim Zhuzhi** behet zoterues i 100 % te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise.

Nga ky moment pala shitesese nuk ka me pretendime per sa eshte realizuar shitja me palen blerese.

Kontrata hartohet ne baze te nenit 705 e vijues te K.Civil ne fuqi dhe ligjit nr. 7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare".

Kontrata pasi iu lexua paleve me ze te larte, u gjet e rregullt sipas deshires dhe vullnetit te lire e te plote te tyre e nenshkruhet rregullisht para meje noterit dhe une e vertetoj ate.

SHITES

Maksim Zhuzhi

P A L E T

Notere  
Dhimitra Qarri

BLERES

Lirim Zhuzhi

Lirim Zhuzhi